

S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
<hr/>	
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakët e Shoqërisë S2 Albania sh.p.k

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **S2 Albania sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në bazat për opinion të kualifikuar, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin e kualifikuar

Siç përshkruhet në shënimin 1.1 të pasqyrave financiare, Shoqëria operon në bazë të marrëveshjes së konçesionit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Të gjithë investimet e kryera nga shoqëria janë njohur dhe paraqitur në zërin e Aktiveve Afatgjata Materiale në përputhje me **SKK 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale"** dhe të amortizuara në përputhje me vlerësimet e përshkruara në shënimin 3.4 të këtyre pasqyrave financiare. Ndërkohë, kushtet e kësaj marrëveshjeje janë në përputhje dhe duhet të trajtohen sipas modelit financiar në kuadër të **SKK 13 "Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare"**. Bazuar në informacionin që kemi, ne nuk mund të vlerësojmë efektin që trajtimi i marrëveshjes së konçesionit sipas kërkesave të SKK 13 në vend të SKK 5 do të kishte në aktivet afatgjata materiale, aktivet financiare, fitimet e pashpërndara dhe fitimin e vitit aktual.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë S2 Albania sh.p.k për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, kanë qënë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar mbi këto pasqyra financiare më 11 qershor 2018.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Teit Gjini
Auditues ligjor

29 korrik 2019



S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	276,909,192	9,827,809
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	123,007,342	128,646,201
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	347,671,275	133,908,274
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	106,031,501	25,455,862
Shpenzime të shtyra	8	135,778,953	3,409,538
Aktive tatimore të shtyra	25	46,758,853	143,729,795
Total Aktive Afatshkurtra		1,036,157,116	444,977,479
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	752,820,183	819,506,905
Shpenzime të shtyra	8	266,842,873	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	10	6,465,994	6,465,994
Total aktive afatgjata		1,026,129,050	825,972,899
Total Aktive		2,062,286,166	1,270,950,378
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	18,044,645	17,729,296
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	1,269,283,736	49,339,359
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	13	252,108,764	935,304,299
Detyrime tatimore	14	125,978,263	4,895,409
Provizione	15	2,463,758	2,463,758
Të tjera detyrime	16	13,346,871	7,244,339
Total Detyrime afatshkurtra		1,681,226,037	1,016,976,460
Detyrime afatgjata			
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	13	40,020,254	40,020,254
Total Detyrime afatgjata		40,020,254	40,020,254
Totali i detyrimeve		1,721,246,291	1,056,996,714
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		1,000	1,000
Rezerva ligjore		100	100
Fitime të mbartura		213,952,564	6,331,190
Fitimi i ushtrimit		127,086,211	207,621,374
Total kapitali aksionar	17	341,039,875	213,953,664
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		2,062,286,166	1,270,950,378

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	1,532,302,532	1,566,965,766
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	51,100,129	6,213,068
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(898,214,449)	(837,445,557)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	20	(794,479,357)	(734,040,255)
2) Të tjera shpenzime	21	(103,735,092)	(103,405,302)
Shpenzime te personelit	22	(224,192,024)	(183,085,555)
1) Paga dhe shpërblime		(201,513,882)	(164,473,233)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(22,678,142)	(18,612,322)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(172,989,120)	(204,305,750)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(564,332)	(7,466)
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		(74,445,212)	(79,496,198)
Shpenzime financiare	24	11,059,629	(7,815,851)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		11,059,629	(7,815,851)
Fitimi/humbja para tatimit		224,057,153	261,022,457
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(96,970,942)	(53,401,083)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	(104,467,162)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		(96,970,942)	51,066,079
Fitimi/humbja e vitit		127,086,211	207,621,374
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		127,086,211	207,621,374

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vittit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2017	1,000		(132,746,285)	139,077,575	6,332,290
Fitim / Humbja e vittit				207,621,374	207,621,374
Lëvizje përmes kapitalit		100	139,077,475	(139,077,575)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	1,000	100	6,331,190	207,621,374	213,953,664
Fitim / Humbja e vittit				127,086,211	127,086,211
Lëvizje përmes kapitalit			207,621,374	(207,621,374)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	1,000	100	213,952,564	127,086,211	341,039,875

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori më __.03.2019 dhe janë firmosur si më poshtë:

Jonathan Fleming
 Administrator



S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	127,086,211	207,621,374
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	(602,638)	70,226
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	96,970,942	53,401,083
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	172,989,120	204,305,750
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(474,149,068)	(134,076,097)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	658,147,045	242,690,576
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	6,102,532	2,890,549
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	586,544,144	576,903,461
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(106,302,398)	(5,021,676)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(106,302,398)	(5,021,676)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(213,763,001)	(581,292,623)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(213,763,001)	(581,292,623)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	266,478,745	(9,410,838)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	9,827,809	19,308,873
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	602,638	(70,226)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 276,909,192	9,827,809

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "S2 Albania" është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 22.05.2013.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është zbatimi i marrëveshjes së koncesionit në lidhje me skanimet e mallrave të importuara, automjeteve, kontenjerëve etj në pikat doganore Shqiptare si dhe cdo aktivitet tjetër lidhur me këtë ose i kërkuar për të realizuar zbatimin e marrëveshjes. Shoqëria ka të drejtën të kryejë cdo transaksion si veprimtari tregtare, financiare, qiradhënie, qiramarrje etj që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për arritjen e objektivit të lartpërmendur të shoqërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga dytesore Tirane-Durrës, km 9, godina nr pasurie 83/7/3 zona kadastrale 2105.

Administrator i shoqërisë "S2 Albania" është Z.Jonathan Fleming.
Ajo është regjistruar në Drejtorinë e Tatimpaguesëve të Mëdhenj me NIPT L31722010Q.
Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte 122 punonjës (2017: 97 punonjës).

1.1. Marrëveshja e Koncesionit

Përshkrimi i marrëveshjes

Marrëveshja Koncesioni është lidhur midis Ministrisë së Financave, (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë) duke vepruar për llogari të Republikës së Shqipërisë sipas autorizimit dhënë nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 2.11.2011, dhe Rapiscan Systems, INC. me numër 954-41- 3488, shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Kalifornisë, USA, për "**Financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në republikën e shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit**" Shoqëria Rapiscan Systems, INC themeloi shoqërine S2 Albania shpk për qëllime të Marrëveshjes së Koncesionit.

Periudha e marrëveshjes

Marrëveshja e Koncesionit është lidhur për një periudhë prej 15 vjet dhe fillon nga data efektive e operimit për cdo pikë doganore operimi.
Data efektive e operimit në pikën e parë doganore është 07 Shtator 2015.

Objekti i marrëveshjes

Autoriteti me anë të kësaj Kontrate angazhon operatorin për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje për të siguruar zbatimin e projektit, dizejnimin, testimin dhe operimin e sistemit, duke ofruar shërbimet e përcaktuara dhe transferimin e vendeve dhe pajisjeve tek Autoriteti mbas mbarimit të kohëzgjatjes në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Kontrate. Detyrimet e operatorit për të siguruar skanimin e konteinerëve do të limitohet vetëm brenda vendeve dhe shërbimeve të përcaktuara.

Sipas Marrëveshjes shoqëria ushtron operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në pesë pika doganore; i) Durrës, ii) Kapshticë, iii) Kakavijë, iv) Qafë Thanë, v) Morinë

Pagesa

Autoriteti do t'i paguajë operatorit një tarifë për shërbimet e caktuara për çdo vend (Tarifa e Shërbimit të Vendit).
Tarifa e Shërbimit të Vendit do të llogaritet dhe do të paguhet në këste mujore të njëjta, secila në vlerën e 1/12 të Tarifës Vjetore të Vendit. Tarifa e Shërbimit të Vendit do të jetë pa TVSH.

Tarifa e koncesionit

Operatori detyrihet t'i paguajë Autoritetit një tarifë mujore koncesioni të llogaritur në 2% të Tarifës së Shërbimit të Vendit. Kjo tarifë koncesionare mbahet nga Tarifa e Shërbimit të Vendit që i paguhet operatorit nga Autoriteti.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3 Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/ALL	123.42	132.95
USD/ ALL	107.82	111.10

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktiviteti e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	276,898,069	9,706,353
<i>Banka në Lekë</i>	3,994,579	3,605,256
<i>Banka në EUR</i>	264,112,884	6,042,283
<i>Banka në USD</i>	8,790,606	58,814
Arka	11,123	121,456
Totali	<u>276,909,192</u>	<u>9,827,809</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	123,007,342	128,646,201
Totali	<u>123,007,342</u>	<u>128,646,201</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Hua për Rapiscan UK	347,671,275	133,908,274
Totali	<u>347,671,275</u>	<u>133,908,274</u>

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Shteti TVSH për tu marrë	218,313,305	143,868,093
Zhvlerësim i kërkesave të arkëtueshme për TVSH	(218,313,305)	(143,868,093)
Tatim Fitimi	106,031,501	25,455,862
Totali	<u>106,031,501</u>	<u>25,455,862</u>

Lëvizja e zhvlerësimit gjatë periudhës:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Çelja më 1 Janar	143,868,093	64,371,895
Zhvlerësimi gjatë vitit	74,445,212	79,496,198
Gjëndja 31 dhjetor	<u>218,313,305</u>	<u>143,868,093</u>

Shoqëria ka zhvlerësuar kërkesat e arkëtueshme për TVSH-në sipas politikave të saj të zhvlerësimit të kërkesave të arkëtueshme të vjetra mbi 365 ditë.

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Afatshkurta		
Shpenzime të shtyra për licence	133,421,436	-
Shpenzime për shërbime teknike	2,183,600	2,291,800
Parapagime ndaj furnitorëve	89,486	20,134
Shpenzime për përshtatje ambjenti	84,431	1,097,604
Afatgjata		
Shpenzime të shtyra për licence	266,842,873	-
Totali	<u>402,621,826</u>	<u>3,409,538</u>

S2 Albania sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Pajisje kompjuterike	Instrumenta Pune	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	1,240,504,989	17,328,551	3,711,722	4,510,778	2,766,475	1,268,822,515
Shtesa	-	-	3,530,917	930,271	560,488	5,021,676
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	1,240,504,989	17,328,551	7,242,639	5,441,049	3,326,963	1,273,844,191
Shtesa	103,699,585	-	387,157	2,215,656	-	106,302,398
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	1,344,204,574	17,328,551	7,629,796	7,656,705	3,326,963	1,380,146,589
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	241,077,647	5,896,469	1,087,387	1,480,897	489,136	250,031,536
Amortizimi i vitit	199,885,468	2,286,416	784,614	858,596	490,656	204,305,750
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	440,963,115	8,182,885	1,872,001	2,339,493	979,792	454,337,286
Amortizimi i vitit	168,550,007	1,829,133	1,098,166	1,042,380	469,434	172,989,120
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	609,513,122	10,012,018	2,970,167	3,381,873	1,449,226	627,326,406
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	999,427,342	11,432,082	2,624,335	3,029,881	2,277,339	1,018,790,979
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	799,541,874	9,145,666	5,370,638	3,101,556	2,347,171	819,506,905
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	734,691,452	7,316,533	4,659,629	4,274,832	1,877,737	752,820,183

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

10. Të tjera llogari të arkëtueshme afatgjatë

Llogaritë e tjera të arkëtueshme afatgjatë për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Garanci për Qira	2,497,718	2,497,718
Garanci bankare për kartën e kreditit	3,968,276	3,968,276
Totali	<u>6,465,994</u>	<u>6,465,994</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Furnitorë vendas	5,217,706	1,512,448
Furnitorë të huaj	12,826,939	16,216,848
	<u>18,044,645</u>	<u>17,729,296</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Tregtare ndaj palëve të lidhura	1,269,283,736	49,339,359
	<u>1,269,283,736</u>	<u>49,339,359</u>

13. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Afatshkurta		
Shpenzime për fatura të pa mbëritura	3,317,237	3,813,645
Të tjera shpenzime të përlogaritura	248,791,527	931,490,654
Afatgjata		
Të tjera shpenzime të përlogaritura	40,020,254	40,020,254
	<u>292,129,018</u>	<u>975,324,553</u>

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Tatimi mbi të ardhurat personale	2,331,828	1,801,166
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,539,774	2,681,769
Tatim në burim	120,106,661	412,474
	<u>125,978,263</u>	<u>4,895,409</u>

15. Provizione për rreziqe

Provizionet afatshkurtra dhe afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten në tabelen e mëposhtme:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Balanca në çelje	2,463,758	2,463,758
Provizion i periudhës	-	-
Balanca në fund	<u>2,463,758</u>	<u>2,463,758</u>

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 përbëhen nga detyrimet për pagat e punonjësve dhe paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Pushime të përllogaritura	13,292,608	7,244,339
Të tjera detyrime	54,263	-
Totali	<u>13,346,871</u>	<u>7,244,339</u>

17. Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë "S2 Albania" sh.p.k është 1,000 lekë, i ndarë në 1,000 kuota me vlerë nominale 1 lek.

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga shërbimi i skanimit	1,532,302,532	1,566,490,276
Të ardhura nga shërbime	-	475,490
Totali	<u>1,532,302,532</u>	<u>1,566,965,766</u>

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

19. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Fitime nga kursi i këmbimit nga aktiviteti i shfrytëzimit	117,815,278	60,636,693
Humbje nga kursi i këmbimit nga aktiviteti i shfrytëzimit	(66,715,149)	(54,423,625)
Totali	<u>51,100,129</u>	<u>6,213,068</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Qarkullim i tatueshëm	1,532,302,532
Shuma e qarkullimit e korrektuar	<u>1,532,302,532</u>
Sipas Kontabilitetit	1,532,302,532
Diferenca	-
Fitim nga këmbimet valutore	117,815,278
Të ardhura nga interesat	11,059,629
Total të ardhura deklaruar në deklaratën e Tatim Fitimit	<u>1,661,177,439</u>

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shërbime për kuotën pjesë të vlerës së investimeve ndërtimore të kryera dhe shërbimet, mirëmbajtjen operacionale të pikave	334,283,420	338,681,245
Mark tregtare dhe Royalties	71,981,368	86,358,136
Shpenzime për shfrytëzim licence teknike software	136,037,543	95,058,333
Shërbime manaxheriale	156,163,474	107,612,391
Mirëmbajtje dhe riparime pajisjet	50,901,750	62,328,899
Tarifa e koncensionit	30,646,051	31,329,806
Shpenzime për karburant makinat	5,431,307	4,476,789
Uniforma për punonjësit	3,187,312	2,901,490
Shpenzime trainimi punonjësit	2,182,590	1,935,800
Qera makina	2,043,817	1,765,472
Materiale të konsumueshme	1,020,287	312,189
Shpenzime dosimetrimi dhe kalibrimi	425,400	276,113
Shpenzime transporti	175,038	1,003,592
	<u>794,479,357</u>	<u>734,040,255</u>

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime qiraje	20,193,850	20,840,275
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	28,177,028	19,012,531
Konsulenca ekonomike dhe juridike etj	21,572,795	37,105,618
Energji elektrike,ujë	8,396,125	7,341,847
Siguracione	7,561,256	7,742,844
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	4,848,858	2,897,335
Materiale të konsumueshme	3,218,940	959,186
Mirembajtje dhe riparime	2,450,029	2,100,745
Shpenzime për pritje	2,225,257	457,151
Taksa dhe kontroll teknik makinat	1,729,677	846,220
Taksa Lokale	1,024,567	805,938
Kancelari	998,215	2,097,645
Shpenzime marketingu dhe publiciteti	702,872	512,580
Komisione bankare	458,549	502,944
Shpenzime rekrutimi	130,751	121,155
Shpenzime të tjera	46,323	60,238
Shpenzime administrative	-	1,050
	<u>103,735,092</u>	<u>103,405,302</u>

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Paga dhe shpërblime	196,903,959	161,582,687
Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	22,678,142	18,612,322
Shpenzime të përllogaritura për punonjësit	4,609,923	2,890,546
	<u>224,192,024</u>	<u>183,085,555</u>

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Gjopa dhe penalitete	564,332	7,466
Totali	<u>564,332</u>	<u>7,466</u>

24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për interesa	-	8,605,902
Të ardhura nga interesat	(11,059,629)	(790,051)
	<u>(11,059,629)</u>	<u>7,815,851</u>

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	224,057,153	261,022,457
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	(544,118,179)	435,425,289
Shpenzime pritje dhe percjellje	392,719	175,986
Shpenzime udhëtimi	25,001,997	13,532,685
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	564,332	7,466
Shpenzime të përlllogaritura përkohësisht të pa njohura	259,851,157	337,549,981
Rimarrje përlllogaritje shpenzimesh	(910,934,026)	-
Zhvlerësim i kerkesave për arketim (TVSH)	74,445,212	79,496,198
Rimarrje e shpenzimeve të përlllogaritura për punonjësit nga viti i kaluar	(3,267,942)	(3,360,808)
Shpenzime të përlllogaritura për punonjësit	7,877,865	6,251,354
Shpenzime të tjera	1,950,507	1,772,427
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(320,061,026)	696,447,746
Fitimi Fiskal	(320,061,026)	696,447,746
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin 15%	-	104,467,162
Tatim fitimi i shtyrë	96,970,942	(51,066,079)
	<u>127,086,211</u>	<u>207,621,374</u>

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

25.1 Tatimi i shtyrë:

25.1.1 Paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të perlllogaritura përkohësisht të pa njohura	46,067,365	142,643,142
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të perlllogaritura për punonjësit	691,488	1,086,653
Tatim i shtyrë e aktiv (detyrim)	<u>46,758,853</u>	<u>143,729,795</u>

25.1.2 Paraqitur në Pasqyrën e Performances Financiare

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Tatim fitimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) për shpenzime të perlllogaritura përkohësisht të pa njohura	(97,662,430)	50,632,497
Tatim fitimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) për shpenzime të perlllogaritura për punonjësit	691,488	433,582
Tatim i shtyrë e ardhur (shpenzim)	<u>(96,970,942)</u>	<u>51,066,079</u>

25.1.3 Rakordimi

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Balanca me 01 janar	<u>143,729,795</u>
Tatimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) gjatë vitit	(96,970,942)
Balanca më 31 dhjetor	<u>46,758,853</u>
Llogaritja e Tatim fitimit të shtyrë për periudhën	
Shpenzime të perlllogaritura përkohësisht të pa njohura	259,851,157
Rimarrje perlllogaritje shpenzimesh nga vitet e kaluara	(910,934,026)
Shpenzime të perlllogaritura për punonjësit	7,877,865
Rrimarje e shpenzimeve të perlllogaritura për punonjësit nga viti i kaluar	(3,267,942)
Total	<u>(646,472,946)</u>
Tatim fitimi i shtyrë 15%	<u>(96,970,942)</u>

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

26. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Rapiscan UK	642,543,946	14,962,318
Rapiscan USA	23,699,272	-
OSI Corporate	182,103,466	-
ICMS	32,870,152	34,377,041
S2 Global	388,066,900	
	<u>1,269,283,736</u>	<u>49,339,359</u>
	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të arkëtueshme nga palëve të lidhura		
Rapiscan UK	347,671,275	133,908,274
	<u>347,671,275</u>	<u>133,908,274</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017</u>
Blerje		
Rapiscan UK	799,328,252	31,655,365
Rapiscan USA	31,619,383	-
OSI Corporate	255,312,313	2,722,587
ICMS	334,283,420	338,681,245
S2 Global	494,553,289	-
	<u>1,915,096,657</u>	<u>373,059,197</u>
	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017</u>
Shitje		
Rapiscan USA	-	570,588
Rapiscan UK	790,051	-
	<u>790,051</u>	<u>570,588</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

27. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2018, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.